



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 225, datë 08.05.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga raportore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :
“..Subjekti ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti kualifikon drejt marrëdhënien juridike, njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit. Ajo njeh dhe zbaton parimet procedurale

gjatë gjykimit, siç janë parimi i legjitimitetit të paleve (shih dokumentin 3 dhe dosjen 3), parimin e disponibilitetit të padisë (shih dokumentin 3 dhe dosjen 2), parimin sipas të cilit, barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor i takon organit të administratës publike (shih dokumentet 2, 3 dhe dosjet 2 e 3). Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton rastin kur ai është absolutisht i pavlefshëm nëpërmjet argumentave të saktë ligjore (shih dosjen 3). Kur është rasti, përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre (shih dokumentet 2 dhe 3, si dhe dosjet 2 e 3). Gjyqtarja identifikon saktë rastet kur marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës dhe kur ato rregullohen nga ligje të tjera të veçanta (shih dosjet 2, 4 dhe 5)... Ajo njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit, siç janë parimi i legjitimitetit të paleve (shih dokumentin 3 dhe dosjen 3), parimin e disponibilitetit të padisë (shih dokumentin 3 dhe dosjen 2), parimin sipas të cilit, barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor i takon organit të administratës publike (shih dokumentet 2, 3 dhe dosjet 2 e 3). Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton rastin kur ai është absolutisht i pavlefshëm nëpërmjet argumentave të sakte ligjore (shih dosjen 3). ... Kur është rasti, gjyqtare {...} në zgjidhjen e çështjes, referon në praktikën inifikuese të Gjykatës së Lartë (shih dosjet 4 dhe 5).

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes, pasqyron procedurën e ndjekur nga gjykata dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë apo thirrjen në gjykim të personit të tretë,¹ (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin, pakësimin apo saktësimin e objektit të padisë².

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i identifikuar ato në pjesën më të madhe të vendimeve burim vlerësimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit”³. Faktet e çështjes në çdo rast janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në përmbajtjen e tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi.

¹Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014; Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015; Vendimi nr. 5650, datë 09.11.2015 dhe Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

³ Thuajse në të gjitha vendimet.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, pas paraqitjes së rrethanave procedurale, analizës së faktit dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke analizuar objektin dhe shkaku e padisë, si dhe përmes gjithë analizës së kuadrit ligjor mbi të cilin themelohet kërkimi. Në këtë kontekst, në lidhje me detyrimin e gjykatës për përcaktimin e saktë të shkakut ligjor të padisë, gjyqtarja referon vendimin unifikues nr.3/2012⁴ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu evidentohet se përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin, administrativ, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, detyrimin për dëmshpërblim, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, shfuqizimin e aktit administrativ dhe detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit, si dhe orienton një vijim arsyetimi ligjor.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se pas pasqyrit të fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht në vendimet burim vlerësimi, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

- nenet 7, 9 dhe 10 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 36 - 40 të K.Pr.Civile në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësor të gjykatës⁵, nenin 31 dhe 192/1 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën për ngritjen e padisë, përcaktimin e objektit të padisë dhe të drejtën për të thirrur persona të tretë në gjykim⁶;
- nenin 26 dhe 35 të ligjit nr. 49/2012, lidhur me parimin procedural të barrës së provës, nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ⁷;
- nenet 38, 39 dhe 40/4 të ligjit nr. 49/2012 në lidhje me vendimet jopërfundimtare dhe përfundimtare të dhëna nga gjykata⁸;
- nenin 45 i ligjit nr. 49/2012 në lidhje me paankimueshmërinë e vendimeve⁹;
- nenin 72 të ligjit nr. 49/2012 në lidhje me afatet e paraqitjes së padisë¹⁰;
- nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 185 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën e disponimit të padisë (shtimin/pakësimin dhe ndryshimin e objektit të padisë)¹¹;
- nenet 510/1/a, 511/1. 609 dhe 610 të K.Pr.Civile në lidhje ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, urdhrin e ekzekutimit dhe kundërshtimin e veprimeve përmbare si dhe nenet 449,

⁴ Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁵ Dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore referohen thuajse në çdo vendim burim vlerësimi.

⁶ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁷ Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014, Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015, Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016; Vendimi nr. 1659, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁸ Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁹ Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁰ Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹¹ Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014, Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 5650, datë 09.11.2015 dhe Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

451 dhe 479 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimin e formës së prerë gjykatës si titull ekzekutiv, pezullimin e ekzekutimit të vendimit¹²;

- nenin 161/c të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 192 të K.Pr.Civile lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë apo thirrjen në gjykim të personit të tretë¹³;
- nenet 115, 116 dhe 117 të K.Pr.Administrative mbi shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;¹⁴ dhe nenet 121, 124, 136, 137, 139 146 të K.Pr.Administrative në lidhje me ankimimin administrativ¹⁵;
- nenet 3, 4¹⁶, 5, 6, 12, 21, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 153, 155 të Kodit të Punës, në funksion të vlerësimit mbi zbatimin e Kodit të Punës në hapësirë, kohë, ndaj personave dhe sipas materies, afatin e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën, shkaqet e zgjidhjes së kontratës, pasojat që vijnë prej zgjidhjes së marrëdhënies së punës¹⁷;
- nenin 256 i K.Pr.Civile, në fakt është shënuar përmbajtja e nenit 253 i K.Pr.Civile në lidhje me vërtetësinë e akteve që përpilohen para nëpunësit të shtetit¹⁸;

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- nenet 144, 192, 193, 198, 200, 201, 202, 203, 206, 214 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 të “Kodit rrugor në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor dhe ndëshkimin në lidhje me shkeljen e këtyre rregullave¹⁹;
- nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 13, 14, 16, 20, 23 dhe 26 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”²⁰;
- nenet 114/b dhe 130/a/2/a të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” në lidhje me detyrimin e shfrytëzuesve të veprave artistike/shkencore për të lidhur kontratë me shkrim me autorët e tyre dhe ndëshkimi i shkeljeve²¹;
- nenet 13, 80, 105 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” në lidhje me administratën tatimore, funksionimin e saj, strukturat e hetimit tatimor²²;
- nenin 2, 3, 19 dhe në përgjithësi frymën e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe nenin 8 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” dhe VKM nr. 455, datë 29.10.1992 dhe VKM nr. 257, datë 05.06.1992 në lidhje me procedurën e ndjekur dhe vlefshmërinë e akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP)²³;
- nenet 1, 2, 24, 57, 60, 63, 66 dhe 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe në VKM nr. 230, datë 07.04.2010 “Për përcaktimin e përgjegjësive të institucioneve të qeverisjes vendore” në

¹² Vendimi nr. 275, datë 28.01.2016; Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹³ Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁴ Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015, Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016, Vendimi nr. 1659, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁵ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁶ Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁷ Vendimi nr. 5810, datë 20.10.2014, Vendimi nr. 509, datë 10.02.2016, Vendimi nr. 2909, datë 03.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁸ Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁹ Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁰ Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015, Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²¹ Vendimi nr. 5650, datë 09.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²² Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²³ Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

lidhje me rregullimin ligjor të marrëdhënies së nëpunësit civil me shtetin, shkeljet në shërbimin civil, masat disiplinore dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil²⁴;

- nenet 57, 77 dhe 78 të ligjit nr. 9794 datë 04.06.2007 “Për policinë e shtetit” në lidhje me lirim dhe përjashtimin nga policia e shtetit dhe të drejtën e ankimit²⁵;
- nenin 83/5 i ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” në lidhje me procedurat e konstatimit të kundravajtjes, të njoftimit, ankimit dhe masave të tjera administrative dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”²⁶;
- vendimi nr. 2542, datë 13.03.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014” dhe nenet 34, 36, 37 dhe 136 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”²⁷;
- neni 19 i ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” në lidhje me fitimin e tatueshëm, nenet 28, 33, 36, 37, 38 dhe 40 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në lidhje me kreditimin e tatimit dhe nenet 64, 65 dhe 67 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” në lidhje me deklaratën tatimore dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 i Ministrisë së Financave²⁸;
- nenet 3, 78, 78/1 dhe 278/2 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale përkatësisht “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” si dhe nenet 47, 48, 49, 50 dhe 55 të K.Penal në lidhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të saj dhe bashkimi i dënimeve²⁹.

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me procesin e rregullt gjyqësor, pjesë e të cilit është edhe ekzekutimi i një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm³⁰;

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtarja e arrin nëpërmjet analizës së integruar më vete dhe në tërësi të provave, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Edhe në vendimin penal të zgjedhur prej saj,

²⁴ Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁵ Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁶ Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁷ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁸ Vendimi nr. 1659, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

²⁹ Vendimi nr. 1, datë 09.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

³⁰ Vendimi nr. 275, datë 28.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

gjqqtarja shfaq aftësi shumë të larta në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Po kështu, rezultojnë aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet se; “*Subjekti i rivlerësimit {...} ({...}), ka manifestuar aftësitë e duhura në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirësë, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis*

fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme gjithashtu, shoqërohen me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, trezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përqsaur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja interpreton:

- nenet 34 dhe 36 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me detyrimin e organit kompetent për të ekuilibruar gjendjen e tregut si ent rregullator duke zbatuar konceptin e analizës së tregut dhe nenet 37 dhe 136 po të këtij ligji lidhur me përcaktimin e organit ku mund të bëhet ankimi administrativ, nëse organi që ka nxjerrë aktin ka të drejtë apo jo ta rishikojë atë, analizë e ndërthurur me interpretimin e neneve 136, 137, 139 dhe 146 të K.Pr.Administrative, duke konkluduar se ligji specifik prevalon mbi normën e përgjithsme dhe në rastin konkret AKEP nuk mund të ndryshojë vendimet kur situata faktike mbetet e njëjtë dhe nuk mund të silllet si organ epror.³¹;
- nenet 13, 14 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të shkeljes dhe rëndësinë e nënshkrimit të tij nga kundravajtësi apo evidentimit të faktit që kundravajtësi nuk pranon të firmosë në funksion të vlefshmërisë së procesverbalit të konstatimit të shkeljes³²;
- nenin 609 të K.Pr.Civile në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv duke analizuar rastet kur goditet tituli ekzekutiv dhe konkluduar se përvec rastetve të pavlefshmërisë absolute të aktit apo

³¹ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

³² Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- pavlefshmërisë së njoftimit të aktit, goditja e titullit duhet të bazohet vetëm në fakte të ndodhura pas nxjerrjes së aktit.³³;
- nenin 31 dhe 192/1 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën për ngritjen e padisë, përcaktimin e objektit të padisë dhe të drejtën për të thirrur persona të tretë në gjykim³⁴;
 - nenet 2, 24 dhe 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” në lidhje me procedurat e pranimit në shërbimin civil, periudha e provës dhe konfirmimi i stausit si e vetmja mënyrë për t’iu nënshtruar ligjit për shërbimit civil dhe për të përfituar nga benefitet që rrjedhin nga statusi³⁵;
 - Nenin 26 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në funksion të cilësimit të aktit administrativ përfundimtar si titull ekzekutiv, efektet e ankimit administrativ në lidhje me pezullimin e ekzekutimit, sipas parashikimeve, si dhe përcaktimin e efekteve të ankimit administrativ të aktit të dënimit me gjobë sa i përket pezullimit të ekzekutimit të tij³⁶;
 - interpreton nenet 3, 4, 5 dhe 6 të K.Punës, në lidhje me zbatimin e Kodit të Punës, në hapësirë, sipas personave, sipas përmbajtjes dhe në kohë, duke konkluduar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi do të zbatohet ligji Kodi i Punës; trajton konceptin e afatit të njoftimit dhe institutin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, duke u ndalur në zgjidhjen pa shkaqe të arsyeshme dhe zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar, shpërblimin për shkak të vjetërsisë duke interpretuar nenet 140/2, 141, 143, 144, 145, 146, 153, 155 të K.Punës. Po kështu, merr në analizë pasojat e zgjidhjes së kontratës së punës, nisur nga kërkimet e pales, duke referuar, në Vendimin Unifikues nr.19, datë 15.11.2007 të Gjykatës së Lartë lidhur me dëmshpërblimin në rast se nuk provohet ekzistenca e një shkakut justifikues³⁷;
 - nenin 78 të ligjit nr. 9794 datë 04.06.2007 “Për policinë e shtetit” në lidhje me të drejtën e ankimit në rastin e lirimit nga detyra në policinë e shtetit dhe afatet e apelimit, duke interpretuar në funksion të përcaktimit të drejtë të afateve të apelimit nenin 18 të ligjit 49/2012³⁸;
 - nenin 19 dhe në përgjithësi frymën e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” në lidhje humbjen e pronësisë në sipërfaqe në të cilat bëhen ndërtime për nevoja të ndryshme shtetërore, interpretim ky I bërë në funksion të procedurës së ndjekur dhe vlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), pra nuk mund të kalosh të drejta të cilat nuk i ke vetë³⁹;
 - nenet 13, 80, 105 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” në lidhje me administratën tatimore, funksionimin e saj, strukturat e hetimit tatimor me qëllim verifikimin e iniciativës ligjore nga organi që ka nisur hetimin duke konkluduar se organi që ka nisur hetimin ka patur tagër për ta bërë këtë dhe se është detyrë parësore e cdo organi tatimor vënia në dijeni të faktit se një tatimpagues është duke shkelur ligjin⁴⁰;
 - nenet 510/1/a, 511/1. 609 dhe 610 të K.Pr.Civile në lidhje ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, urdhrin e ekzekutimit dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore në rastin kur titulli ekzekutiv është një vendim gjykate. Gjyqtarja bën analizën juridike mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv kur detyrimi i vendosur nga gjykata nuk ekziston më, në rastin kur ngjarja apo fakti i ri ka ndodhur pasi vendimi ka marrë formë të prerë. Thelbi i arsyetimit, i mbështetur në qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, është vendosja përballë njëra tjetrës e fuqisë që ka vendimi gjyqësor i formës së prerë në fazën e ekzekutimit gjyqësor si pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe pamundësisë së ekzekutimit të tij për fakte të lindura më pas.⁴¹;

³³ Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

³⁴ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

³⁵ Vendimi nr. 6464, datë 12.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

³⁶ Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015, Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁷ Vendimi nr. 5810, datë 20.10.2014, Vendimi nr.509, datë 10.02.2016, Vendimi nr. 2909, datë 03.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁸ Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁹ Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁰ Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴¹ Vendimi nr. 275, datë 28.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- nenin 114/b të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” në lidhje me detyrimin e shfrytëzuesve të veprave artistike/shkencore për të lidhur kontratë me shkrim me autorët e tyre dhe mungesa e kësaj të fundit con në kundravajtje administrative⁴²;
- neni 19 i ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” në lidhje me fitimin e tatueshëm ku duhet të ketë një përputhje mes asaj që deklaron tatimpaguesi dhe asaj që konstatojnë organet tatimore; nenin 33 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në lidhje me kreditimin e tatimit duke treguar efektin juridik dhe ekonomik që ka një transaksion i pasqyruar në një faturë tatimore dhe nevojën për përcaktimin e konceptit të faturës tatimore dhe elementëve të saj si dhe nenin 38/1 të po këtij ligji në lidhje me periudhën tatimore, vetdeklarimin e tatimpaguesit i cili duhet të bëhet në përputhje të plotë me librat tregtarë të detyrueshëm me ligj për t’u mbajtur dhe në funksion të analizës së deklaratave tatimore, interpreton nenet 64, 65 dhe 67 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”⁴³;
- në funksion të përcaktimit të natyrës së pavlefshmërisë së aktit administrativ dhe dallimit ndërmjet dy llojeve të pavlefshmërisë, pavlefshmërisë absolute dhe pavlefshmërisë relative, gjyqtarja interpreton në mënyrë literale nenet 115, 116, 117 të K.Pr.Administrative, duke referuar, edhe pse pa përcaktuar konkretisht vendimet, praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë lidhur me pavlefshmërinë absolute;⁴⁴
- nenet 78, 78/1 dhe 278/2 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridic të veprave penale përkatësisht “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” duke bërë një analizë abstrakte të të katër elementëve për secilën veprë penale dhe duke e ndërthurur me rrethanat konkrete në të cilat janë kryer veprat penale⁴⁵.

Në lidhje me normat procedural, gjyqtarja ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpreton nenin 38 të ligjit 49/2012 në lidhje me moszbatimin e një akti nënligjor nga ana e gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor të veprimit administrative, kur çmon se akti është i paligjshëm duke analizuar kushtet kur jemi para këtij kërkimi duke konkluduar se pjesë e urdhërimit të gjykatës nuk mund të jetë një kërkim që nuk është pjesë e padisë⁴⁶;
- interpreton nenet 39 dhe 40/4 i ligjit nr. 49/2012 në lidhje me vendimet jopërfundimtare dhe përfundimtare të dhëna nga gjykata⁴⁷ ;
- interpretim i nenii 72 të ligjit nr. 49/2012 në lidhje me afatet e paraqitjes së padisë, ku afatet e përcaktuara nga ligji i posaçëm prevalojnë mbi afatet e përcaktuara nga ky ligj⁴⁸ ;
- interpreton nenin 35 të ligjit organik nr.49/2012, në drejtim të përcaktimit në çdo rast të barrës së provës në gjykimin administrativ dhe vlerësimit të fakteve objekt gjykimi në raport me barrën e provës të përcaktuara në mënyrë të shprehur në çdo rast, në raport me kuptimin e dispozitave të referuara. Thuajse në të gjitha vendimet ku interpretohet neni 35, kjo bëhet në korelacion me nenin 26 të ligjit “Për kundravajtjet administrative”⁴⁹;

⁴² Vendimi nr. 5650, datë 09.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴³ Vendimi nr. 1659, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁴Vendimi nr. 4181, datë 22.07.2015, Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016, Vendimi nr. 1659, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁵ Vendimi nr. 1, datë 09.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë

⁴⁶ Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁷ Vendimi nr. 5030, datë 12.10.2015, Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014; Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁸ Vendimi nr. 1582, datë 11.4.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁹Në të gjitha vendimet burim vlerësimi normat e zbatueshme lidhur me parimin procedural të barrës së provës interpretohen në shërbim të përcaktimit të qartë të saj, në raport me kërkimet objekt padie.

- interpreton nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ⁵⁰ etj.

Në disa nga vendimet janë interpretuar dispozita të akteve nënligjore që gjejnë zbatim. Konkretisht, gjyqtarja:

- interpreton nenin 2 të VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” lidhur me përfitimin e familjes bujqësore që ka kontribuar në ndërtimin e ndërmarrjes bujqësore nëpërmjet dorëzimit të tokës bujqësore dhe interpretimin në tërësi të frymës së kësa VKM-je në lidhje me procedurën e ndjekur dhe vlefshmërinë e akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP)⁵¹.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- në vendimin nr.275, datë 28.01.2016, gjyqtarja referon vendime të ndryshme të GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese pa përmendur numrin dhe datën në lidhje me fazën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor si pjesë e procesit të rregullt gjyqësor; referon në vendimet nr. 32, datë 26.05.2014; nr. 17, datë 23.04.2013; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 36, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010 dhe nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 13, datë 21.03.2012; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 6, datë 06.03.2009 dhe nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ekzekutimin në kohë të vendimeve të formës së prerë dhe vonesa në ekzekutim nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës; referon në vendimet nr. 32, datë 26.05.2014; nr. 17, datë 23.04.2013; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 8, datë 23.03.2010; nr.9, datë 01.04.2009 dhe nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të cilat llogariten nga momenti i fillimit të procedurës deri në dhënien e vendimit e më pas në ekzekutimin e tij ku faza e ekzekutimit konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces; referon në vendimet nr. 32, datë 26.05.2014; nr. 17, datë 23.04.2013; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010 dhe nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kohëzgjatjen e konsiderueshme të çështjeve e cila mund të justifikohet me kompleksitetin e çështjes në balancë me parimin e sigurimit të të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë; referon në vendimin nr. 32, datë 26.05.2014 në lidhje me formën e prerë të vendimeve të Gjykatave të Apelit dhe se rekusi nuk e pezullon ekzekutueshmërinë e tyre përveçse kur Gjykata e Lartë vendos pezullimin e ekzekutimit dhe se të gjithë subjektet duhet të përgjigjen njëjloj përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke referuar në vendimin nr. 7, datë 27.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese; referon në vendimet nr. 13, datë 21.03.2012 dhe nr. 43, datë 19.12.2007 në lidhje me sigurinë që shteti duhet t’i garantojë palëve në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe në vendimin nr. 2, datë 01.02.2011 në lidhje të drejtën e kreditorit.
- në lidhje me përgjegjësinë e gjykatës për përcaktimin e shkakut ligjor të padisë, pa u lidhur me pretendimet e palëve, krahas përcaktimit të natyrës së mosmarrëveshjes në raport me shkakun ligjor të saj, referohet edhe vendimi unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;⁵²
- referon vendimin unifikues nr.19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara ta Gjykatës së Lartë në lidhje me institutin e zgjidhjes së kontratës së punës⁵³;

⁵⁰Vendimi nr. 1567, datë 01.04.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵¹ Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵²Vendimi nr. 6136, datë 31.10.2014; Vendimi nr.509, datë 10.02.2016; Vendimi nr. 5810, datë 20.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵³ Vendimi nr. 2909, datë 03.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton gjyqtarja zbaton *parimin e procesit të rregullt ligjor*, pasi referuar kontekstit të arsyesimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejtë aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktorialitetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, të parimit absolut të paditësit për të disponuar mbi padinë, në rastin e pranimit të kërkesës për ndryshimin apo shtimin e objektit të padisë, etj. Në vendimet burim vlerësimi ka analizë të *parimit procedural të barrës së provës*, parim i cili referohet dhe analizohet në çdo vendim burim vlerësimi ky parim referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përcaktuar në mënyrë të shprehur barrën e provës, në raport me parashikimet e ligjit të posaçëm nr.49/2012 apo Kodit të Punës në raste të veçanta, si dhe duke analizuar lidhur me mënyrën e zbatimit të tij referuar natyrës së çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të zbatuar, referuar dhe kur është rasti për të analizuar aspektet të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme, si në aspektin procedural ashtu edhe në thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes. I njëjti kujdes tregohet edhe në të vetmin vendim penal të marrë në vlerësim ku gjyqtarja ndalet në analizën e të gjithë elementëve të veprave penale. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ në mbështetje të argumenteve të saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përta i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁵⁴.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor...”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se;

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore përfundimtare, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁵⁵ Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

⁵⁴ Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

⁵⁵P.sh : *lex specialis, lex generalis, ratio loci, ratio personae; ratione materia; ratione temporis; de facto, de jure; etj.*

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyës apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarës për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Vendimet janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

Në vendimet përfundimtare burim vlerësimi gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë në çdo rast elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet prospektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këto elementë kanë qenë të diskutueshme nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, në të gjitha vendimeve e analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zberthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve procedurale të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Struktura është e qëndrueshme e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet në çdo rast. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese arsyetuese në nënndarje, të identifikuar më tituj duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit/mbrojtësit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i mosmarrëveshjes administrative apo akuza në çështjen penale, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve (apo prokurorit dhe të pandehurit në vendimin penal), të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Gjithashtu në këtë pjesë, analizohet kryesisht nga gjykata juridiksioni, kompetenca lëndore dhe tokësore.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtarja:

- (i) ndalet në paraqitjen e padisë nga pala paditëse, si dhe evidentimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. kërkesa për marrjen e masës ë sigurimit të padisë, shtimin e ndërgjyqësisë pasive, apo ndryshimin/pakësimin e objekti të padisë, thirrjen e personave të tretë, etj.
- (ii) *Faktit dhe rrethanat e provuara në gjykim.* Në këtë pjesë gjyqtarja përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar i provuar në gjykim.
- (iii) *Pretendimet dhe prapësimet e palëve,* pjesë në të cilën gjyqtarja parashtron në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e secilës palë së bashku me argumentet e tyre.
- (iv) *Kuadri ligjor dhe zgjidhja juridike e çështjes,* në të cilën gjyqtarja fillimisht citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative, civile dhe penale, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik, merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij, parapara aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja ka ndjekur metodën IRAC,⁵⁶ duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, pyetjet/çështjet ligjore të vlerësuara thelbësore, për zgjidhjen e çështjes konkrete, dhe duke organizuar më pas analizën ligjore në drejtim të përgjigjes së këtyre pyetjeve, ndërsa në disa vendime është shprehur që në fillim mbi bazueshmërinë ose jo në prova dhe në ligj të kërkesë padisë⁵⁷.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtares dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin/rrëzimin apo mospranimin e kërkesë padisë*), si dhe disponimin mbi shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshme.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e mirë strukturuar, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

⁵⁶IRAC - *Issue, Rule, Application, Conclusion*

⁵⁷ Vendimi nr. 4570, datë 05.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formular. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁵⁸

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, vlerësuesi nuk është shprehur lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin administrativ, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkruar të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtares për provueshmërinë e fakteve konkrete. Gjyqtarja zhvillon

⁵⁸ *Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.*

analizën juridike për secilin kërkim të ngritur në kërkesëpadi (*ose pasi ka parashtruar çështjet/pyetjet ligjore për diskutim*), ku integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet kujdesi që gjyqtarja tregon në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar parimet e së drejtës, institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke treguar kujdes të posaçëm për evidentimin dhe argumentimin ligjit të marrëdhënies shkak-pasojë, në përqasjen e ligjit me faktet konkrete.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsyetimit, pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsyetimit të vendimit. Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga çështja apo pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtares për zgjidhje dhe hap pas hapi evidentohet logjika me të cilin gjyqtarja i përgjigjet çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtares për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues nuk ka të dhëna.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares Enerjeta {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet, pra datën e shortimit të secilës çështje dhe datën e vendimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si kërkesa për sigurimin e padisë për të cilën neni 28, pika 3 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, nuk rezulton që për shqyrtimin e tyre, ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi.

Pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna të tjera që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, prezumohet se gjyqtarja i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit. Gjithsesi ajo ka respektuar të gjitha afatet procedurale të parashikuara nga ligji 49/2012 për kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale. Prandaj vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi.** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja vlerësohet dhe të pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor dhe ka respektuar në çdo rast afatet procedurale të parashikuara në ligj për kryerjen e veprimeve të caktuara.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :” Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtare {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 13 dite (dosjen 5) deri ne 7 muaj e 5 dite (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 7 muaj e 5 ditë ka qenë çështja administrative, me objekt kundërshtimin e sanksionit administrative (gjobë), ka patur mungesa të sekretarës së gjyqtarës dhe vet kësaj të fundit për shkaqe shëndetësore (shkaqe objektive); ka patur shtyrje seance për shkak të moosmarrjes dijeni rregullisht nga palët (për faj tësherbimit postar), si dhe ka patur shtyrje seacash për paraqitje provash nga pala e paditurr (shih dosjen 3). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj e 14 ditë (shih dosjen 4), 3 muaj e 27 ditë (shih dosjen 2) dhe 2 muaj e 18 ditë (shih dosjen 1). Në të pesë dosjet e vëzhguara, është shkelur afati standard i

gjykimit nga ana e gjyqtares {...}. Megjithatë, kemi theksuar në përmbajtje të këtij raporti se, ligji specifik nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative", i miratuar me vonë se vendimi nr. 261/2, datë të KLD-së "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtareve», nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit administrativ, përveç afateve specifike të parashikuara në nenet 25, 26 e 27 të tij, afate që rezultojnë të jenë respektuar nga gjyqtarja {...} në katër dosjet e vë zhguara (dosjet 1, 3, 4 dhe 5)...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, dhe materiali për një çështje të administruar për shkak të ankesave, i evidentuar nga Inspektoriati i KLD për efekt vlerësimi etij dhe profesionale.

Për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 2 vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja si dhe materiali për 1 çështje të administruara për shkak të ankesave, gjykimi ka zgatur vetëm për një çështje më pak se 1 muaj ndërsa për çështjet e tjera gjykimi ka tejkaluar standardin minimal kohor 1/muaj, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht çështjet kanë përfunduar brenda afateve nga 1 muaj e 13 ditë minimalisht deri në 7 vit e 5 ditë në çështjen që i përket vendimit nr. 6136, datë 31.10.2014 (dosja 3).

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit në gjykatën e shkallës së parë dhe as për shqyrtimin e tyre nga gjykata e apelit si shkallë e parë dhe as për çështje, shqyrtimi i të cilave kalon në seancë gjyqësore. Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, ai parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Ndërkohë, në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezultojnë të jetë përcaktuar standardin minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e administrative të shkallës së parë, por afate gjykimi të shqyrtimit të këtyre mosmarrëveshjeve nga seksioni administrativ, që funksiononte në atë kohë. Lidhur me standardin minimal, në pikën 5, gërma c të Aneksit nr.1 të Vlerësimit parashikohet se;”*Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj.*”.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatën mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, çaktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.C për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues ende në fuqi.

Në këtë rast, respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodit i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, konstatohet se:

- (i) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 1582, datë 11.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shfuqizimin e aktit administrativ”*, rezultoi të jetë regjistruar në datë 23.01.2014, i është shortuar gjyqtarës në datë 24.01.2014 dhe ka përfunduar në datë 11.04.2014, brenda një afati prej 2 muaj e 16 ditë, apo për 76 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (ii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 6464, datë 12.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shfuqizim vendimi i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Arsimit”*, rezultoi të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 15.07.2014, dhe ka përfunduar në datë 12.11.2014, brenda një afati prej 3 muaj e 27 ditë. Megjithatë po të zbrisim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezultoi se çështja ka përfunduar për 2 muaj e 27 ditë, apo për 87 ditë, **aq sa afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (iii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 6136, datë 31.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shfuqizimin vendimi “Njoftim vlerësimi tatimor”*, rezultoi të jetë regjistruar në datë 21.03.2014, i është shortuar gjyqtarës në datë 25.03.2014 dhe ka përfunduar në datë 31.10.2014, brenda një afati prej 7 muaj e 6 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Megjithatë po të zbrisim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë

- lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 6 muaj e 6 ditë apo për 186 ditë, përsëri **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (iv) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr nr. 2909, datë 03.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Konstatim i zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 18.03.2014, i është shortuar gjyqtares në datë 19.03.2014 dhe ka përfunduar në datë 03.06.2014, brenda një afati prej 2 muaj e 15 ditë, apo për 75 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (v) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.509, datë 10.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shpërblim page nga marrëdhënia e punës”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 24.12.2015, i është shortuar gjyqtares në datë 28.12.2015 dhe ka përfunduar në datë 10.02.2016, brenda një afati prej 1 muaj e 13 ditë, apo për 44 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (vi) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 4570, datë 05.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shfuqizimin e plotë të AMTP...”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 21.02.2014, i është shortuar gjyqtares në datë 24.02.2014 dhe ka përfunduar në datë 05.09.2014, brenda një afati prej 6 muaj e 11 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 5 muaj e 11 ditë apo 161 ditë, përsëri **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (vii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 5810, datë 20.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shpërblim page nga marrëdhënia e punës”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 19.06.2014, i është shortuar gjyqtares në datë 20.06.2014 dhe ka përfunduar në datë 20.10.2014, brenda një afati prej 4 muaj, apo për 120 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 3 muaj apo 90 ditë, duke e tejkaluar afatin me 3 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i pa përfillshëm, e për pasojë do të konsiderohet se është shqyrtuar **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (viii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 5030, datë 12.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 23.06.2015, i është shortuar gjyqtares në datë 24.06.2015 dhe ka përfunduar në datë 12.10.2015, brenda një afati prej 3 muaj e 18 ditë, apo për 108 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 2 muaj e 18 apo 78 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (ix) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 4181, datë 22.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Anullim i vendimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë..”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 24.06.2015, i është shortuar gjyqtares në datë 25.06.2015 dhe ka përfunduar në datë 12.10.2015, brenda një afati prej 27 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (x) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 275, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv.”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 31.07.2015, i është shortuar gjyqtares në datë 28.10.2015 dhe ka përfunduar në datë 28.01.2016, brenda një afati prej 3 muaj, apo 90 ditë, duke e tejkaluar afatin me 3 ditë, tejkalim i cili konsiderohet i pa përfillshëm, e për pasojë do të konsiderohet **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (xi) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 5650, datë 09.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv.”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 21.09.2015, i është shortuar gjyqtares në datë 22.09.2015 dhe ka përfunduar në datë 09.11.2015, brenda një afati prej 1 muaj e 18 ditë, apo 48 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**

(xii) Vendimin nr. 1659, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt "Anullim i pjesshëm të njoftim vlerësimi tatimor.", rezulton të jetë regjistruar në datë 06.02.2014, dhe ka përfunduar në datë 15.04.2014, brenda një afati prej 2 muaj e 9 ditë, apo 69 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**

(xiii) Vendimin nr. 1567, datë 01.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt "Shquqizim vendimi.", rezulton të jetë regjistruar në datë 16.04.2015, dhe ka përfunduar në datë 01.04.2016, brenda një afati prej 11 muaj e 14 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Edhe po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 10 muaj e 14 apo 314 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.**

Gjyqtarës Enerjeta {...} i është evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik një vendime, që i përket periudhës së vlerësimit, konkretisht:

- Çështja administrative nr.4530 akti, datë regjistrimi 15.04.2014, përfunduar me vendimin nr.4907, datë 19.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton të ketë përfunduar brenda një afati prej 5 muaj e 4 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.** Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, si dhe afatin prej 20 ditësh gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësore si dhe është shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e saj, rezulton se çështja ka përfunduar për 3 muaj e 15 apo 105 ditë, **jashtë afatit minimal prej 87 ditësh.**

Referuar afatit 87/ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 14 çështje të analizuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje vetëm matematikore, vetëm 4 prej tyre ose 28 % e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati. Duke iu referuar kohëzgjatjes së 4 çështjeve të përfunduara tej këtij afati, rezulton se për 1 prej tyre, afati 87 ditor është tejkaluar vetëm me 18 ditë, dhe për 3 në një çështje ky afat është tejkaluar me më shumë se 1 muaj, 1, 2 dhe 8 muaj. Kështu po të zbresim edhe 1 çështjet për të cilën tejkalimi i afatit është me disa ditë, rezulton se vetëm për 3 çështje apo për 21 % të tyre kanë përfunduar tej afatit standard.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme (28%) pikëzohet me 3/pikë. Gjithashtu edhe përqindja me 21% pikëzohet me 3 pikë, duke e tejkaluar me 1 % pikëzimin me 4 pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Pavarësisht se për 28 % të çështjeve të shqyrtuara (burime vlerësimi), rezulton tejkalim i standardit minimal kohor të pranuar prej 18 ditë, 1 muaj, 2 muaj dhe 1 çështje me 8 muaj, rezulton se ka qenë përgjithësisht pasojë e ecursionit procedurale të çështjes dhe në disa raste për shkak të mosformimit të trupit gjykues (mungesës së gjyqtarës për arsye shëndetësore e provuar me raport shëndetësor), mosnjoftimit rregullisht të palëve ndërgjyqëse për shkak të problemeve të shërbimit postar apo adresave të pasakta, mungesës së palëve ndërgjyqëse, mosparaqitjes së provave nga pala e paditur, njoftimin e kërkesave për shtimin apo saktësimin e objektit të padisë sipas nenit 185 të K.Pr.Civile, marrja e provës me ekspert, kërkesave të palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim, shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, Gjyqtarja ka përfunduar në total për një periudhë prej thujse 2/vite e 6 muaj periudhë vlerësimi (nga data 04.11.2013 deri në datë

12.04.2016)⁵⁹, 1462 çështje gjithësej, nga të cilat 937 çështje administrative, 192 marrëdhënie pune, dhe 334 çështje të tjera (kërkesa dhe urdhëra ekzekutimi). Pra përgjatë kësaj periudhe ajo ka gjykuar 1129 çështje me palë kundërshtare, mesatarisht rreth 451.6 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 150 çështje themeli në vit, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së, pika “c”⁶⁰, duke qenë mbi standardin minimal të shqyrtimit të çështjeve në masën 201 %, ngarkesë në punë që e justifikon pikëzimin maksimal të gjyqtarës.

KONKLUZIONE

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87 ditor dhe jo 1 mujor;
- (ii) raportit të çështjeve të gjykuara tej këtij standardi me numrin total të çështjeve të analizuara, që rezulton në masën 28 % ;
- (iii) faktorëve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës ;
- (iv) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së në masën 201 % , vlerësohet se për këtë tregues Gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues Gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 28 % të çështjeve jashtë standardit minimal prej 78 ditëve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkalim i standardit sasior me 201 %).

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

⁵⁹ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit ka filluar punë në datë 04.11.2013. Sipas të dhënave statistikore të përcjellë nga Gjykata administrative e Shkallës së parë Tiranë, rezulton se gjyqtarja në muajin Prill 2016 ka marrë lejen e lindjes, konkretisht në datë 12.04.2016.

⁶⁰ Pika 3, germa (c) e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtaqtarëve, parashikon se;”Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; c. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrative, jo më pak se 150 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të KLGJ-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga tre kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat administrative (*administrative me palë kundërshtare, marrëdhënie pune dhe administrative pa palë kundërshtare*). Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, në kushtet kur një vendim është me natyrë penale dhe nuk ka të dhëna të sakta për kohën kur i është shortuar gjyqtarës, si dhe 1 çështje të administruar për efekt të ankesave.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardin minimal kohor 87 ditë, si afat minimal i nevojshëm për respektimin e afateve procedurale të domosdoshme, sipas kategorisë së çështjeve (të gjitha çështjet janë çështje administrative me palë kundërshtare ose marrëdhënie pune), rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është e përafërt ose më e gjatë se standardi minimal kohor për secilën nga dy kategoritë të cilave i përkasin çështjet e analizuara.

Konkretisht :

(i) *për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare”,* koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 11 çështjeve të kësaj kategorie⁶¹, rezulton të jetë 112 ditë, apo 3 muaj 22 ditë, më e gjatë se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori, duke e tejkaluar standardin minimal me 25 ditë.

(ii) *për kategorinë e çështjeve “marrëdhënie pune”,* koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 3 çështjeve që i përkasin kësaj kategorie⁶², rezulton të jetë 70 ditë, apo 2 muaj e 10 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori çështjesh.

Duke iu referuar arsyetimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të dy kategoritë e çështjeve për të cilat ka të dhëna, rezulton si më poshtë:

(i) *për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare”,* koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 11 çështjeve të kësaj kategorie, rezulton të jetë 3 muaj 22 ditë (112 ditë), më e gjatë se standardi kohor 87 ditë, duke e tejkaluar atë me 25 ditë. Në kohën mesatare për këtë kategori çështjesh, ndikon ndjeshëm kohëzgjatja e çështjes që i përket vendimit nr. 1567, datë 01.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i përzgjedhur nga gjyqtarja, e cila ka përfunduar për rreth 314 ditë, për të cilën nuk ka të dhëna për kohën e shortimit si dhe shkaqet e shtyrjeve të seancave, si dhe çështja që i përket vendimit nr. 6136, datë 31.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka zgjatur për rreth 6 muaj e 6 ditë, apo 186 ditë, ku 2 seanca janë shtyrë për shkak të pamundësisë së gjyqtarës për tu paraqitur në punë për arsye shëndetësore, duke çuar në shtyrjen e tyre

⁶¹ Vendimi 2, vendimi 3, dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 6, dosja 8, dosja 9, dosja 10, dosja 11 dhe materiali që i përket vendimit nr nr.4907, datë 19.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, administruar për shkak të ankesave.

⁶² Dosja 4, dosja 5 dhe dosja 7.

për rreth 42 ditë. Nëse në përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje nuk do të konsiderohej këto dy çështje e administruar, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për këtë kategori, për 9 çështje, rezulton 82 ditë, më e shkurtër se afati 87 ditor. Megjithatë nëse për çështjen që i përket vendimit nr. 6136, datë 31.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, do të zbresimim afatin prej 42 që është shtyrë për shkaqe shëndetësore të gjyqtares, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 88.5 ditë, duke e tejkalluar standardin me 1.5 ditë, tejkallim i cili konsiderohet i papërfillshëm.

- (ii) *për kategorinë e çështjeve “marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 3 çështjeve që i përkasin kësaj kategorie, rezulton të jetë 2 muaj e 10 ditë (70 ditë), më e shkurtër se afati 87 ditor, i pranuar si standard minimal kohor.*

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të dy kategoritë për të cilat ka të dhëna, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, shkallë aftësie e cila sipas metodologjisë përkon me pikëzimin me 3 pikë. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, vetëm për një kategori, tejkallohet vetëm me 25 ditë, ku ndikon ndjeshëm vetëm nga 1 çështje e cila ka zgjatur për rreth 314 ditë, dhe për të cilën nuk ka të dhëna për kohën e shortimit si dhe shkaqet që kanë ndikuar në zgjatjen e këtij gjykimi, duke qenë se është vendimi i zgjedhur nga gjyqtarja, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, vlerësohet se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

KONKLUSIONE:

Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.”*), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve, shkallë aftësie e cila sipas metodologjisë përkon me pikëzimin me 3 pikë. Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), konkretisht duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjeve dhe të zgjatjeve të gjykimeve, të cilat kanë qenë kryesisht për shkaqe procedurale, në disa raste të mungesës së gjyqtares për arsye të përligjura (raport shëndetësore) por edhe të mungesës së njoftimeve të palëve, komplekistetit të çështjeve, ku është dashur marrja edhe e provës me ekspert, apo thirrje të personave të tretë, ngarkesën e gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, ku rezultoi se asaj i janë caktuar mesatarisht rreth 1485 çështje për një periudhë prej gati 2 vjet e gjysmë, ka përfunduar rreth 1462 çështje gjithësej, nga të cilat 1129 çështje janë me palë kundërshtarë, mesatarisht rreth 451.6 çështje themeli në vit apo 584.8 çështje gjithësej, faktin se ajo e ka tejkalluar standardin minimal mesatarisht me 301 çështje themeli në vit apo me rreth 201 %, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke arritur në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për gjykimin administrativ, për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: *“..Subjekti i rivlerësimit/ ne periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016/ ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë (08.10.2013 - 04.11.2013)/ si dhe detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (04.11.2013 - 08.10.2016). Ajo ka deklaruar se në këtë periudhë/ i janë caktuar, për gjykim 1844 çështje dhe ka përfunduar 1769 çështje gjyqësore/ duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 73 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 95.9 %.”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 3 vite kalendarike, dy prej të cilëve janë jo të plotë, rezulton se :

Në total në gjithë periudhën e vlerësimit, nga dita që gjyqtarja ka filluar punë efektivisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë (04.11.2013) deri në datë 12.04.2016, kur gjyqtarja ka marrë leje lindje, gjyqtarës i janë caktuar 1485 çështje dhe ka përfunduar 1485 çështje⁶³, ndërsa sipas të dhënave statistikore të dërguara me shkresën me nr.9256, datë 06.10.2020, rezultoj se gjyqtarja gjatë kësaj periudhe ka përfunduar gjithësej 1462 çështje, pra rendimenti i llogaritur në total rezulton 98.5 %. Ndërsa e ndarë në vite rezulton si më poshtë;

Për vitin 2013 (04.11.2013-31.12.2013), i janë caktuar për gjykim 51 çështje, ka përfunduar 21 çështje dhe ka mbartur 30 çështje, me një rendiment prej 41 %

Për vitin 2014 (1.1.2014-31.12.2014), i janë caktuar për gjykim 767 çështje, ka përfunduar 692 çështje dhe ka mbartur 105 çështje, me një rendiment prej 90.6 %

Për vitin 2015 (1.1.2015-31.12.2015), i janë caktuar për gjykim 618 çështje, ka përfunduar 650 çështje dhe ka mbartur 73 çështje, me një rendiment prej 105.2 %.

Për vitin 2016 (1.1.2016-12.04.2016), i janë caktuar për gjykim 49 çështje, ka përfunduar 122 çështje, dhe nuk ka mbartur asnjë çështje, duke qenë se gjyqtarja është larguar me leje lindje, me një rendiment prej 248.9%.

Duke marrë parasysh faktin që periudha e vlerësimit shtrihet në 4 vite kalendarike, dhe për dy prej tyre nuk përfshijnë një vit të plotë kalendarik, në kushtet kur gjyqtarja ka filluar punë në gjykatën administrative në datë 04.11.2013 dhe më pas është larguar me leje lindje në muajin prill 2016, ku dosjet i janë shortuar deri në datë

⁶³ Shih vërtetimin nr.778 prot., datë 24.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

12.04.2016, rendimenti i përfundimit të çështjeve nuk mund të përlogaritet për secilën nga katër periudhat pasi do të përbënte një tregues të pasaktë. Për efekt të analizës, më poshtë do të përcaktohet rendimenti që rezulton për secilën periudhë kohore për të cilën të dhënat statistikore ofrojnë mundësi përlogaritje, dhe më pas do të përlogaritet rendimenti për të gjithë periudhën e vlerësimit. Kështu, për dy periudhat që përfshijnë vite të plota kalendarike (viti 2014 dhe 2015) rendimenti i gjyqtarës rezulton 90.6 % dhe 105.2 %, me një mesatare prej 97.9.

Për gjithë periudhën e vlerësimit e cila përbëhet nga 3 vite, rendimenti i gjyqtarës, referuar deklarimeve të saj rezulton të jetë 95.9 %, sikurse është konkluduar edhe në raportin e Inspektoratit të KLD. Ndërsa rendimenti i rillogaritur, duke e marrë të gjithë periudhën e vlerësimit, gjatë secilës gjyqtarja ka kryer funksionin efektivisht pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, rezulton të jetë 98.5 %, ndërsa për dy vite të plota (viti 2014 dhe viti 2015) për të cilat ka të dhëna të plota, rendimenti rezulton në vlerën e 97.9 % (si mbledhje e mesatare e dy viteve).

Duke iu referuar përqindjeve të rendimentit të gjyqtarës, që ka rezultuar nga Raporti i Vlerësimit të KLGJ, në vlerën e 95.9 % si dhe rendimentit të rillogaritur për dy vite të plota pune, në vlerën e 97.9 %, përqindje këto që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohen me 8 pikë (mbi 93-99 %/8 pikë).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”* Nga burimet e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për tu marrë në konsideratë nga vlerësuesi për të konkluduar në një nivel më të lartë pikëzimi.

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës {...} ({...}), të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë vijon :

Në lidhje me periudhën që ajo ka punuar si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (04.11.2013 -12.04 2016), nga të dhënat statistikore të gjykatës rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 1462 çështje gjyqësore (1129 çështje me palë kundërshtare dhe 333 kërkesa dhe urdhëra ekzekutimi), pra mesatarisht 451.6 çështje themeli në vit, duke e tejkaluar standardin minimal sasior sa i takon çështjeve administrative me palë kundërshtare të gjykuara, me 201 %.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 95.9 % i përcaktuar në Raportin KLGJ-së, apo me 97.9 % i rillogaritur edhe njëherë referuar të dhënave statistikore, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh faktin se gjykata administrative ka filluar punë efektivisht në datë 04.11.2013 dhe në muajin Prill 2016 gjyqtarja është larguar me leje lindje, faktin se në çdo vit ajo e ka tejkaluar standartin minimal të ngarkesës në punë, mesatarisht me rreth 201 % në vit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se në çdo vit ajo e ka tejkaluar standartin minimal sasior, mbi 50 %, konkretisht me 201 %.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “..Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtare {...}, nuk ka mundur të respektojë në të pesta rastet e vëzhguara, afatin ligjor 7 ditor të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012. Kështu, konstatohet se në dy raste, vendimi është dorëzuar 2 dite vonese, pra përtej afatit ligjor prej 7 ditësh (shih dosjen nr. 2) dhe për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 3). Në tre dosjet e tjera, afati 7 ditor të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012, është respektuar nga gjyqtare {...}. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 9 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 13 ditë nga shpallja (shih dosjen 3) dhe për 7 ditë nga shpallja (shih dosjet 4 e 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim si dhe për 1 çështje, për shkak të ankesës, e cila i është evidentuar gjyqtarës për efekt vlerësimi nga Inspektoriati i KLD.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 1582, datë 11.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është dorëzuar më datë 16.04.2014, 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (ii)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 6464, datë 12.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 21.11.2014, 9 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke e tejkaluar këtë afat me 2 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm;
- (iii)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 6136, datë 31.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 13.11.2014, 13 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke e tejkaluar këtë afat me 6 ditë.
- (iv)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 2909, datë 03.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 10.06.2014, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
- (v)*** Dosja që i përket vendimit me nr.509, datë 10.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 17.02.2016, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (vi)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 4570, datë 05.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 12.09.2014, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (vii)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 5810, datë 20.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 28.10.2014, 8 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke e tejkaluar këtë afat me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm e për pasojë do të konsiderohet i dorëzuar brenda afatit ligjor;
- (viii)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 5030, datë 12.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 16.10.2015, 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (ix)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 4181, datë 22.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 29.07.2015, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (x)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 275, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 04.02.2016, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (xi)*** Dosja që i përket vendimit me nr. 5650, datë 09.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është dorëzuar më datë 16.11.2015, 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjyqtares Enerjeta {...} i është evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik një vendime në lidhje me kohën e arsyetimit të vendimi, që i përket periudhës së vlerësimit, konkretisht:

(xii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.1614, datë 14.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Nga verifikimi i kësaj çështje saj ka rezultuar se vendimi gjyqësor është zbritur në kryesekretari në datë 23.04.2014. Nga verifikimi i regjistrit themeltar administrative, ka rezultuar se data e zbardhjes së vendimit është e korigjuar (mund të jetë 23 apo 28.04.2014), pra në qoftë se do të marrin në konsideratë datën 23, rezulton se vendimi është dorëzuar 8 ditë pas shpalljes, dhe në rast se do të marrim në konsideratë datën 28.04.2014, vendimi është dorëzuar brenda 13 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 7 ditorë, 7 ditor përcaktuar në nenin 55/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 çështje e evidentuar për efekt të vlerësimit profesional nga ish KLD për shkak të ankesave, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë 7.4 ditë, nëse do të marrin në konsideratë afatit 7 ditorë të dorëzimit të vendimit të verifikuar për shkak të ankesave dhe 7.9 ditë nëse do ta marrim si afat të dorëzimit të këtij vendimi 13 ditë nga shpallja, pra më e gjatë se afati i parashikuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012, duke e tejkuluar këtë afat më pak se një ditë, e për pasojë do të konsiderohen se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është sa afati ligjor prej 7 ditësh.

Duke iu referuar dy kategorive të çështjeve, rezulton se:

- (i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është **7.4 ditë**, duke e tejkuluar afatin 7 ditorë vetëm me disa orë apo me 0.4 ditë.
- (ii) për kategorinë “marrëdhënie pune”⁶⁴, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është **7.3 ditë**, duke e tejkuluar afatin 7 ditorë vetëm me disa orë apo me 0.3 ditë.

Sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, rezulton “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*” dhe sipas metodologjisë pikëzohet me 15 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, në kushtet kur rezultoi se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësor është tejkuluar me rreth 0.3 apo 0.4 ditë për dy kategoritë e çështjeve, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm, kjo kohë do të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për kwtw tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

⁶⁴ Dosja 4, dosja 5 dhe dosja 7.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “..Gjyqtare {...}, ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore. Ajo në katër dosje të vëzhguara, është konstatuar se respekton afatin ligjor 7 ditor për vënien në levizje të dosjes dhe kryen me korrektësi veprimet përgatitore të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”, ku konstatohet se: i njofton të paditurit aktet dhe i cakton afat atij për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, aktet e paraqitura prej të paditurit ia njofton paditësit, zhvillon seancë përgatitore dhe kur vlerëson se aktet janë të plota e kalon çështjen për gjykim. Përrjashtimisht, në dosjen nr. 2, veprimet përgatitore në dhomë këshillimi u kryen 15 ditë pas marrjes me short të çështjes, pra, në tejkalim të afatit 7 ditor të parashikuar nga neni 25 pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Duke i kushtuar rëndësi veprimeve përgatitore, ajo e përfundon gjykimin me 1-3 seanca gjyqësore. I kushton rëndësi edhe dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve. Ndjek me rigorozitet radhën e veprimeve procedurale, siç përcaktohet nga ligji, gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (shih dosjet 4 dhe 5), me 4 seanca (shih dosjen 1), me 6 seanca (shih dosjen 2) dhe me 10 seanca (shih dosjen 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 24 seanca gjyqësore nga të cilat vetëm 7 prej tyre, kanë qenë jo-produktive. Shkak për dështimin e shtatë seancave kanë qenë mungesa e gjyqtares në dy seanca për shkaqe mjekësore (objektive), mungesa e sekretares së gjyqtares me raport mjekësor, dështimi i seances për shkak të mosmarrjes dijeni rregullisht të palëve ndërgjyqëse, për datën dhe orën e seancës dhe shtyrja e seancave për paraqitje provash nga palët. Nga tetë dokumentat e shqyrtuara, nuk rezultoi në asnjë rast që të jetë cënuar ndonje vendim i gjyqtares {...} nga gjykatat më të larta, për mosrespektim të procedurave gjyqësore apo edhe për shkaqe të tjera.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (çështje administrative me palë kundërshtare dhe marrëdhënie punë) , si dhe materialet për një çështje të referuar për vlerësim etik dhe profesional, për të cilën ka të dhëna, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezulton si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

- (i) **Dosja 1**, çështja me nr. regjistri 1172, datë regjistrimi 23.01.2014, përfunduar me vendimin nr.1582, datë 11.04.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore** të dokumentuar nëpërmjet procesverbalit me shkrim. Nuk ka seanca jo produktive. Seanca e parë gjyqësore është shtyrë për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin përfundimtar.
- (ii) **Dosja 2**, çështja me nr. regjistri 6522, datë regjistrimi 15.07.2014, përfunduar me vendimin nr. 6464, datë 12.11.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **5 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive. Një seancë është shtyrë për të njoftuar kërkesën për saktësimin e objektit të padisë palëve në mungesë, dy seanca janë shtyrë për t'i lënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet e fundit me shkrim, ku në një seancë pala e paditur nuk i ka pasur gati, dhe një seancë për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012.
- (iii) **Dosja 3**, çështja me nr. regjistri 3623, datë regjistrimi 21.03.2014, përfunduar me vendimin nr. 6136, datë vendimi 31.10.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seancë gjyqësore**, ku seancë e dytë është shtyrë për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, duke përfunduar me shpalljen e tij.
- (iv) **Dosja 4**, çështja me nr. regjistri 3492, datë regjistrimi 18.03.2014, përfunduar me vendimin nr. 2909, datë vendimi 03.06.2014. Për përfundim e saj është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin.
- (v) **Dosja 5**, çështja me nr. regjistri 7680/1102, datë regjistrimi 24.12.2015, përfunduar me vendimin nr. 509, datë vendimi 10.02.2016. Për përfundim e saj është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin.

Në çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

- (vi) **Dosja 6**, çështja me nr. regjistri 2645, datë regjistrimi 21.02.2014, përfunduar me vendimin nr. 4570, datë 05.09.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **7 seancë gjyqësore**, nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive, 2 të shtyrë për mungesë të gjyqtarës për arsye shëndetësore dhe 1 për shkak të mosnjoftimit të palës së paditur. Seanca e fundit është shtyrë për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin përfundimtar.
- (vii) **Dosja 7**, çështja me nr. regjistri 6065, datë regjistrimi 19.06.2014, përfunduar me vendimin nr. 5810, datë 20.10.2014. Për përfundim e saj janë planifikuar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive, një e shtyrë për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim dhe një për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës gjykata ka shpallur vendimin.
- (viii) **Dosja 8**, çështja me nr. regjistri 4781, datë regjistrimi 23.06.2015, përfunduar me nr. 5030, datë 12.10.2015. Për përfundim e saj janë zhvilluar **4 seanca gjyqësore**, një nga të cilat ka qenë jo produktive, e shtyrë për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarës. Ndërsa një është shtyrë për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim dhe një për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin.
- (ix) **Dosja 9**, çështja me nr. regjistri 4805, datë regjistrimi 24.06.2015, përfunduar me vendimin nr. 4181, datë 22.07.2015. Për përfundimin e saj është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin.
- (x) **Dosja 10**, çështja me nr. regjistri 5403/160, datë regjistrimi 31.07.2015, përfunduar me vendimin nr. 275, datë 28.01.2016. Për përfundimin e saj janë zhvilluar **3 seancë gjyqësore**, një e cila është shtyrë për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim dhe një është shtyrë për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës është shpallur vendimin përfundimtar.
- (xi) **Dosja 11**, çështja me nr. regjistri 5948 datë regjistrimi 21.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 5650, datë 09.11.2015. Për përfundimin e saj janë planifikuar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive, një është shtyrë për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim dhe një për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012, në përfundim të cilës gjyqtarja ka shpallur vendimin përfundimtar. nga te cilat janë zhvilluar 3 seanca produktive dhe 2 seanca nuk janë çelur për shkak të angazhimit të gjyqtarës në takime pune, të cilat janë relatuar në procesverbalin e mos çeljes. Seancat gjyqësore janë shtyre për shkaqe të

përligjura që konsistojnë në paraqitjen e ekspertës dhe shtyrjen për shpalljen e arsytuar të vendimit në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012.

Gjyqtarës Enerjeta {...} i është evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik një dosje për zvarritje gjykimi për të cilën ka të dhënë lidhur me këtë tregues, konkretisht:

(xii) Ankesa i përket çështjes me nr.4530 akti, datë 15.04.2014, përfunduar me vendimin nr.4907, datë 19.09.2014. Nga përmbajtja e relacionit për shqyrtimin e kësaj ankese, rezulton se për përfundimin e gjykimit të kësaj ankese janë zhvilluar **6 seanca gjyqësore**. Një seancë është shtyrë me kërkesë të palës së paditur për t'iu përgjigjur me shkrim pyetjeve të palës paditëse, një seancë nuk është zhvilluar për mungesë të gjyqtarës për arsye shëndetësore, një seancë me kërkesë të palës paditëse për tu njohur me përgjigjet me shkrim të palës së paditur, një seancë është shtyrë për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet me shkrim dhe një për të shpallur vendimin, në përfundim të cilës është shpallur vendimin përfundimtar.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 7 seanca. Numri i përgjithshëm i seancave të planfikuar për 12 dosjet e vëzhguara është 38 seanca gjyqësore, nga të cilat 9 seanca janë shtyrë vetëm për të shpallur vendimin, në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012.

Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me pale kundërshtare*” numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.6 seanca gjyqësore; (ii) për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*” numri mesatar është 1.6 seanca gjyqësore .

Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 12 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.1 seanca. Ndërsa po të heqin nga ky numër, seancat e shtyra për të shpallur vendimin, rezulton se numri mesatar i seancave për 12 çështjet është 2.6 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe vetëm në një rast konstatohet që seanca të jetë shtyrë për shkak të mos konfirmimit të marrjes së njoftimit nga pala e paditur (dosja 6).

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mos formimit të trupit gjykues apo angazhimit të gjyqtarës si pjesmarrëse në trajtim në Shkollën e Magjistraturës (vetëm një rast), rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt, përveç periudhës së muajit gusht, gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen vjetore. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, njoftimin e palës së paditur për të cilën nuk konfirmohet dijenia, njoftimin e kërkesës për saktësimin e objektit të padisë, me kërkesë të palëve për të paraqitur përgjigje me shkrim pyetjeve dhe për tu njohur me përgjigjet, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar në referim të parashikimeve të nenit 302 të K.Pr.C, si dhe 9 seanca të shtyrë për shpalljen e vendimit në referim të nenit 42/2 të Ligjit nr.48/2012. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për

shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (*afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar, afati 5 ditor për shpalljen e vendimit të arsyetuar*).

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short, dhe 1 çështje të referuar për shkak të ankesave rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 3.1 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive dhe planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.1 seanca për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare, numër e cila zbret në 2.6 seanca po të zbresim seancat e shtyrë për të shpallur vendimin në referim të nenit 42/2 të ligjit nr.49/2012, dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës pw kwtw tregues” vlerwsohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 3.1 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet sikurse është përshkruar në treguesin 2.B.A, me sipër “*numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtarë (8 çështje administrative me palë kundërshtarë dhe 5 çështje gjyqësore marrëdhënie pune), si dhe 1 çështje e referuar për shkak të ankesave për të cilën ka të dhëna që mund të përdoren për këtë tregues (1 çështje administrative me palë kundërshtar), lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton si më poshtë:

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.48/2012. Edhe tek dosja nr. 2, referuar në raportin e KLGJ, nga ana e gjyqtarës brenda 7 ditëve, konkretisht një ditë pas shortit ka vënë në lëvizje dosjen, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve përgatitore në prezencë të palëve, duke caktuar seancën pas 15 ditëve nga dita e shortit⁶⁵. Në 11 dosjet e vëzhguara rezulton se seanca e parë për kryerjen e veprimeve përgatitore është zhvilluar ditën e shortit (dosja 3, 4, dosja 7, dosja 9, dosja 10), apo 1 ditë pas caktimit të çështjes me short (dosja 5, dosja 8), apo brenda 7 ditëve nga caktimi me shorti (dosja 1 4 ditë pas shortit, dosja 6, 2 ditë pas shortit, dosja 11, tre ditë pas shortit).

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke evidentuar të metat e padisë, njoftimin e palës paditëse për plotësimin e tyre brenda afatit ligjor, vlerëson nevojën ose jo të ekspertimit, disponon për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afati ligjor 10 ditor duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim të provave, gjyqtarja ka zhvilluar menjëherë veprimet përgatitore duke evidentuar në procesverbal veprimet e kryera për verifikimin e njoftimeve drejtuar palës së paditur, datën e komunikimit të tyre, paraqitjen ose jo të prapësimeve me shkrim nga pala e paditur brenda afatit të caktuar nga gjykata, liston provat shkresore të paraqitura nga pala si dhe disponon për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkakun për caktimin e seancës përgatitore. Në dosjet e vëzhguara në çdo rast është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relativitetin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, gjyqtarja, pasi ka dëgjuar palën paditëse, ka relativitetin prapësimet me shkrim të paraqitur nga të paditurit dhe provat shkresore që janë

⁶⁵ Raportin vlerësimit të KLGJ me nr.3313/6 prot., datë 29.09.2021, faqe 17, faqe 1343 e dosjes së rivlerësimit.

paraqitur nga pala në mungesë. Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.C, ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në përgjithësisht, në 9 dosjet e vëzhguara është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, ndërsa në dy dosje seanca është caktuar tej këtij afati, por kjo periudhë në një rast përkon me muajin gusht gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen vjetore dhe në një rast në muajin dhjetor, që përkon me festat e fundvitit dhe mbartjen e dosjeve në fillim të muajit janar të çdo viti. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, është arsyetuar më vete dhe është pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur në mënyrë manuale ose me regjistrim audio, pasi ky sistem është vënë në funksionim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; deponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjyqësorit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; lejimin e shqyrtimit të provave, administrimin e tyre, duke i listuar; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat; dhënien fjalën palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë përgjithësisht të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me ndërgjyqësinë, saktësimin e objektit të padisë, shtyrjen e seancës*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë, vonesa të cilat kanë qenë të papërfillshme në rastin kur seancat janë zhvilluar në regjistrim audio, duke u relatuar shkaku i fillimit me vonese. Seancat gjyqësore, pas datës 26.5.2015 në të cilën ka filluar funksionimi i sistemit të regjistrimit audio të seancave në gjykatë, janë zhvilluar duke u regjistruar në sistem audio.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues, evidentuar në shpejtesinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke

ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në veprimet përgatitore, seancat përgatitore, dhe seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “krÿyerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerre vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia, procesverbali i veprimeve përgatitore në dhomë këshillimi, procesverbali i seancave përgatitore, apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, konkluzionet me shkrim të palëve, vendimi përfundimtar, ankimi i palëve nëse ka, vendimi i gjykatave më të larta etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikepamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet proceduriale.”

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bëtë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjet ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, procesverbalin e shortit, padinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë paraqitur me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet

e njoftimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar (dorëshkrim dhe vendimi i numërtuar) vendimi për pranimin e ankimit në rastet kur palët kanë paraqitur ankim, aktet e njoftimit të vendimit dhe procesverbali audio në rastet kur seancat janë regjistruar në sistem audio. Brenda kategorisë aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet sikurse është përshkruar në treguesin 2.C.A, më sipër “*Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes*”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët (padi, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet e palëve kur ato janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, vendimet e gjykatës për regjistrimin e kërkesë padisë, për kryerjen e veprimeve përgatitore, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, vendimet e ndërmjetëm për shqyrtimin e juridiskionit e kompetencës, procesverbalet e çdo seancë të zhvilluar në dhomë këshillimi, seancë përgatitore dhe gjyqësore, vendimet gjyqësore, vendimet për pranimin e ankimit të palëve ndërgjyqëse, procesverbali audio kur seancat janë zhvilluar me sistem audio).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

1. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paañesi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se “..Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...} ({...}), për periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional. Për gjyqtarën {...}, është depozituar një ankesë në ish-Inspektoriatin e KLD-së e cila me krijimin e ILD-së, i ka kaluar për trajtim këtij të fundit dhe ndodhet në proces verifikimi. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 9 ankesa (5 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 3 të vitit 2016) në Inspektoriatin e ish KLD-së.

Katër ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 2 prej tyre (2 të vitit 2014) janë ankesa të përsëritura, 2 prej tyre (të vitit 2016) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta.

Pesë ankesat e tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 3 ankesa të vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje
- 1 ankesë⁶⁶ sugjeruar verifikim për shkelje etike, i është dërguar ILD-së , e cila pas verifikimit të saj ka vendosur arkivimin.

KLJGJ, me shkresën nr. 2388 prot, datë 13.04.2023 i ka kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vënien në dispozicion të rezultateve të trajtimit të ankesës nr. 647 prot, datë 08.02.2016 që i përket ankuesit B.I dhe trajtimin me përparësi të saj në rast se ankesa nuk është trajtuar. Kjo kërkesë i është ripërsëritur ILD-së me shkresën nr.2388/1, datë 25.04.2023.

Në përgjigje të kërkesës së drejtuar, ILD me shkresën me nr.1186/1 prot., datë 26.04.2023, ka informuar se për këtë ankesë, pas verifikimit përkatës është vendosur arkivimi. Gjithashtu, është administruar edhe vendimi me nr.2256/1 prot., datë 11.11.2022 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasit Z. B.I”, ku nga përmbajtja e tij, rezulton se janë bërë verifikimet përkatëse megjithëse ankesa është arkivuar për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar nga momenti i ndodhjes së shkeljes së pretenduar, nga të cilat nuk rezulton asnjë e dhënë e provuar që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës. Gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin e gjyqtarës.

⁶⁶ Ankesë nr. 647 prot, datë 08.02.2016 që i përket ankuesit B.I

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...}, nga të dhënat e rezultuara nga dosja personale dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në ish-Inspektoriatin e KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional 08.10.2013-08.10.2016, nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtares {...} {...}.”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Vendimi nr. 576, datë 20.10.2022 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave gjatë periudhës së vlerësimit (analizuar në treguesin më sipër), nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 576, datë 20.10.2022, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë për gjyqtarin {...} konkludohet se: “Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së

ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Trupi gjykues vlerëson se diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 2016 nuk janë në masën që cenojnë besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë mase nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ajo nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.⁶⁷”

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës për treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

⁶⁷Vendim nr. 576, datë 20.10.2022 i KPK, faqe 20.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga gjyqtari.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së nuk ka të dhëna për këtë tregues.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, konkludohet se numri i kërkesave të pranuar te palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të jetë i pa konsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është “i pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Nivelin i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit Pikët
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar nga KLGJ konkludohet se; *Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...}({...}) komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, respekton solemnitetin e gjykimit, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave përgatitore dhe gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se: “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës {...} {...}) për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta....”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga tre burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën të bashkëpunimit, passjell si pasojë prezumimin se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ, rezulton se “Gjyqtare {...} ({...}), i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është çertifikuar në 16 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhenat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit) për një periudhë tre vjeçare, ku në një seminar ka qene edhe në cilësinë e "Lehtësueses". Këto të dhëna tregojne se ajo ka marre pjesë në 26 ditë të formimit vazhdues për një periudhë tre vjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ.”.

Referuar vërtetimit me nr. 725 prot, datë 21.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues në 16 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 24 ditë, kryesisht në fushën e së drejtës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Gjithashtu, referuar vërtetimit të mësipërm, rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuese në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në aktivitetin trajnues me temë “Zgjidhja e kontratës së punës”, zhvilluar me datë 16-17 qershor 2015.

Gjithashtu, gjatë periudhës së vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në një aktivitet trajnues jashtë programit të trajnimit vazhdues të Sh. M i cili ka zgjatur dy ditë.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9⁶⁸ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...} ({...}), gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 28 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës administrative dhe gjykimit administrativ, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 30 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtares;

⁶⁸Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarës në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e lehtësueses, me temë “Zgjidhja e kontratës së punës”, zhvilluar me datë 16-17 qershor 2015. Ndërsa, lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ({...}) duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në 1 (një) aktivitet trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese.

Disponueshmëria e gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARËS NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezultojnë referenca të angazhimit të saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Nga dosja personale e gjyqtares rezulton se ajo është angazhuar si eksperte në Projektin e OSCE Prezenca në Shqipëri, Drafting of moot court Departament. Ky projekt dhe kontrata⁶⁹ e lidhur me Prezencën e OSCE në Shqipëri synonte në hartimin e rasteve gjyqësore/kazuseve dhe pjesëmarrje në trupa gjykues të gjyqeve imituese të organizuara me/për shkollën e Avokatisë në Shqipëri.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton angazhimi i gjyqtares në këtë periudhë vlerësimi, në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari, nuk rezulton që gjyqtarja, gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Gjyqtarja është autore e shkrimit “Mendimi i ekspertit në procesin gjyqësor civil dhe çmuarja e tij nga gjykata”, botuar në revistën “Jeta juridike nr. 2, dhjetor 2007 nga Shkolla e Magjistraturës”. Duke qenë se ky botim nuk i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016, nuk do të ndikojë në pikëzimin e saj në këtë kriter.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

⁶⁹ Special Servis Agreement SSA No: 2016/93_2. Kohëzgjatja 01.07.2016-10.07.2017

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		

Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm
--------------------------	-----	--------------

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Piket total		Niveli i vlerësimit	
			100		Shkëlqyeshëm	
Treguesit		Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore		a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
		b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsytimi ligjor		a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
		b. Struktura e qëndrueshme dhe e	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:

	mirë organizuar e vendimit	përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	kategoritë e çështjeve.		Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	+99%	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë

					Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë

dosjen gjyqësore		fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

					Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë

bashkëpunuar	përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta				Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit;	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	• Dosja e rivlerësimit;	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	• Dosja e rivlerësimit;	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			395		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR